



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 16 mars 2015
Nr. ref.: AGJ 782/15

AKTGJYKIM

në

Rastin nr. KO13/15

Vlerësim i një amendamenti të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të propozuar nga pesëdhjetë e pesë deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, dhe të referuar nga Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës më 6 shkurt 2015 me shkresën nr. 05-259/DO-179

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Më 6 shkurt 2015, Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: parashtruesi i kërkesës), në pajtim me nenet 113.9 dhe 144.3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kushtetuta), i referoi Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata) një amendament të Kushtetutës, të propozuar nga 55 (pesëdhjetë e pesë) deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: deputetët).

Objekti i çështjes

2. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi paraprak nga Gjykata që amendamenti i propozuar i Kushtetutës nuk pakëson asnjë nga të drejtat dhe liritë e garantuara me Kapitullin II të Kushtetutës, në pajtim me nenin 113.9 të Kushtetutës.
3. Amendamenti i propozuar është për një paragraf të ri, 8 në nenin 96 [Ministritë dhe Përfaqësimi i Komuniteteve]. Aty thuhet: *“8. Asnjëra nga gjinitë nuk mund të përfaqësohet më pak se në masën 40% në postet e ministrave dhe të zëvendësministrave të Qeverisë së Republikës së Kosovës”.*

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenet 113.9 dhe 144.3 të Kushtetutës dhe në nenet 20 dhe 54 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejshëm: Ligji).

Procedura në Gjykatë

5. Më 6 shkurt 2015, parashtruesi i kërkesës ia referoi Gjykatës amendamentin.
6. Më 6 shkurt 2015, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin nr. GJR. KO13/15, caktoi gjyqtaren Snezhana Botusharova gjyqtare raportuese. Të njëjtën ditë, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin nr. KSH. KO13/15, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Ivan Čukalović dhe Arta Rama-Hajrizi.
7. Më 10 shkurt 2015, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga ai që të ofronte një listë gjithëpërfshirëse me të gjithë emrat e deputetëve dhe me nënshkrimet e tyre. Gjykata, po ashtu, kërkoi nga parashtruesi i kërkesës që t'i ofronte një kopje të njoftimit secilit prej deputetëve që kishin nënshkruar kërkesën dhe, nëse dëshironin, të dorëzonin komente shtesë.
8. Më 10 shkurt 2015, një kopje e kërkesës iu dërgua Presidentes së Republikës së Kosovës, Kryeministrit dhe Avokatit të Popullit.
9. Më 13 shkurt 2015, parashtruesi i kërkesës dorëzoi listën e kërkuar, të nënshkruar nga këta deputetë: Alma Lama, Shpejtim Bulliqi, Emilija Redžepi, Veton Berisha, Teuta Sahatqija, Doruntinë Maloku, Vjosa Osmani, Lirije Kajtazi, Synavere Rysha, Besa Gaxherri, Njomza Emini, Shaip Muja, Armend Zemaj, Anton Quni, Agim Kikaj, Fatmir Limaj, Valdete Bajrami, Shukrije Bytyqi, Haxhi Shala, Zafir Berisha, Sala Berisha Shala, Luljeta Veselaj Gotaj, Nait Hasani, Melihate Tërmerkollli, Fadil Beka, Teuta Haxhiu, Fikrim Damka, Müfera Şinik, Time Kadrijaj, Puhie Demaku, Aida Dërguti, Shqipe Pantina, Besa Baftija, Mexhide Mjaku Topalli, Xhevahire Izmaçu, Nuredin Ibishi, Ganimete Musliu, Pal Lekaj, Rexhep Selimi, Bekim Haxhiu, Kujtim Pacaku, Qerim Bajrami, Danush Ademi, Enver Hoti, Mytaher Haskuka, Fisnik Ismaili, Glauk Konjufca, Berta Deliu Kodra, Blerim Grainca, Blerim Shala, Labinote Demi Murtezi, Naser Osmani, Hatim Baxhaku, Ilir Deda, Teuta Rugova.

10. Deputetët nuk dorëzuan asnjë koment si përgjigje ndaj njoftimit të Gjykatës, të 10 shkurtit 2015.
11. Më 10 mars 2015, gjyqtari raportues i paraqiti raportin Kolegjit shqyrtues. Kolegji shqyrtues e mbështeti atë dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë që ta deklarojë kërkesën të pranueshme për shqyrtim dhe të deklarojë se amendamenti i propozuar pakëson të drejtat dhe liritë e garantuara me Kapitullin II dhe me Kapitullin III të Kushtetutës, si dhe me shkronjën dhe frymën e saj, siç përcaktohet në praktikën gjyqësore të Gjykatës.
12. Të njëjtën ditë, Gjykata mbajti këshillim dhe votoi për rastin.
13. Gjyqtari Kadri Kryeziu nuk mori pjesë në procedurat e Gjykatës dhe në marrjen e vendimit për rastin e tanishëm KO13/15, në bazë të vendimit KK124/14, të 19 gushtit 2014.

Përmbledhja e fakteve

14. Më 29 dhjetor 2014, deputetët, në pajtim me nenin 144 [Amendamenti], paragrafi 1 i Kushtetutës, i propozuan Kryetarit të Kuvendit një amendament të Kushtetutës.
15. Më 6 shkurt 2015, Kryetari i Kuvendit i referoi Gjykatës amendamentin e Kushtetutës, duke kërkuar nga Gjykata të bëjë vlerësim paraprak nëse amendamenti i propozuar pakëson ndonjë të drejtë dhe liri të përcaktuar me Kapitullin II të Kushtetutës.

Pranueshmëria e kërkesës

16. Në mënyrë që të gjykojë kërkesën e parashtruesit, Gjykata duhet të shqyrtojë nëse janë përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara në Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj.
17. Së pari, Gjykata duhet të përcaktojë nëse kërkesa është dorëzuar nga një palë e autorizuar dhe, së dyti, duhet të përcaktojë nëse ka juridiksion për të vlerësuar amendamentin e Kushtetutës, të propozuar nga deputetët, në pajtim me nenin 113.9 të Kushtetutës.
18. Gjykata rikujton se, në bazë të nenit 113.9 të Kushtetutës, *“Kryetari i Kuvendit të Kosovës duhet të referojë amendamentet kushtetuese të propozuara [...]”*.
19. Gjykata vëren se Kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli, referoi amendamentin e propozuar dhe, prandaj, kërkesa është dorëzuar nga pala e autorizuar në bazë të nenit 113.9 të Kushtetutës.
20. Më tej, Gjykata rikujton se, në bazë të nenit 113.9, ajo duhet *“[...] të konstatojë nëse amendamenti i propozuar i zvogëlon të drejtat dhe liritë e garantuara me Kapitullin II të Kushtetutës”*.

21. Rrjedhimisht, Gjykata ka juridiksion për të vlerësuar nëse amendamenti i propozuar zvogëlon të drejtat dhe liritë e garantuara me Kapitullin II të Kushtetutës.
22. Kështu, pasi që kërkesa është referuar nga pala e autorizuar dhe pasi që Gjykata ka juridiksion ta gjykojë rastin, kërkesa është e pranueshme.

Fushëveprimi i vlerësimit

23. Fushëveprimi i vlerësimit të amendamentit të propozuar bazohet në Kapitullin II [Të Drejtat dhe Liritë Themelore], në Kapitullin III [Të Drejtat e Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre] dhe në shkronjën e frymën e Kushtetutës (Shih rastet nr. KO29/12 dhe KO48/12, parashtres i kërkesës: *Kryetari i Kuvendit i Republikës së Kosovës*, Aktgjykim i 20 korrikut 2012; shih, gjithashtu Rastin nr. KO61/12, parashtres i kërkesës: *Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës*, Aktgjykim i 31 tetorit 2012).
24. Gjykata, gjithashtu, konsideron se neni 21 [Parimet e Përgjithshme] i Kushtetutës duhet të lexohet në lidhje me nenin 7 [Vlerat], paragrafi 1, të Kushtetutës. Neni i fundit i përmendur përkufizon vlerat e rendit kushtetues të Republikës së Kosovës që bazohen “*në parimet e lirisë, paqes, demokracisë, barazisë, respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut dhe sundimit të ligjit, mosdiskriminimit, të drejtës së pronës, mbrojtjes së mjedisit, drejtësisë sociale, pluralizmit, ndarjes së pushtetit shtetëror dhe ekonomisë së tregut*”.

Amendamenti i propozuar: paragrafi i ri 8, i nenit 96, të Kushtetutës

25. Amendamenti propozohet të jetë një paragraf i ri pas paragrafit 7 të nenit 96 [Ministritë dhe Përfaqësimi i Komuniteteve] të Kushtetutës, ku thuhet:

“8. Asnjëra nga gjinitë nuk mund të përfaqësohet më pak se në masën 40% në postet e ministrave dhe të zëvendësministrave të Qeverisë së Republikës së Kosovës”.

Arsyet për amendamentin e propozuar

26. Deputetët pretendojnë se, deri më tani, gratë në qeveritë e pasluftës nuk janë përfaqësuar më shumë se në masën 10-15% në postet ministrore, edhe pse raporti gra/burra i popullsisë është 50% me 50%. Në bazë të kësaj, ato/ata konsiderojnë se është “[...] e domosdoshme futja e kuotës gjinore edhe në pushtetin ekzekutiv, si mekanizëm afirmativ për ndryshimin e gjendjes së rëndë të diskriminimit”. Sipas tyre, neni 24 [Barazia para Ligjit], paragrafi 3, i Kushtetutës arsyeton masat afirmative që duhet të merren ndaj “*grupeve më pak të përfaqësuara*”.
27. Deputetët janë të mendimit se imponimi i kuotës gjinore në Kushtetutë përbën një obligim që nuk mund të anashkalohej nga Qeveria dhe i cili është i ngjashëm me garancitë që Kushtetuta e Kosovës ua ofron komuniteteve.
28. Sipas deputetëve, eksperiencat negative e mosimplementimit të Ligjit për barazi gjinore, Nr. 2004/2, të 19 shkurtit 2004, i cili përfshin të gjitha institucionet

dhe organet udhëheqëse, është një arsye tjetër që kjo normë të bëhet normë kushtetuese dhe që Kushtetuta duhet të jetë garantuese e barazisë gjinore.

29. Deputetët, më tej, konsiderojnë se amendamenti i propozuar është në përputhje me objektivat e Rezolutës Nr. 04-R-09 të Kuvendit të Kosovës, të miratuar më 20 dhjetor 2012. Rezoluta mban titullin: *Parimet e Prishtinës nga Samiti Ndërkombëtar i Gruas: "Partneriteti për Ndryshim-Fuqizimin e Gruas"*, të mbajtur më 4-6 tetor 2012. Ato/ata citojnë paragrafin 4 të Rezolutës ku thuhet:

"4. Inkurajon institucionet e Republikës së Kosovës që të ndërmarrim veprime konkrete dhe të vendosin partneritete me institucionet relevante vendore dhe ndërkombëtare për të përmbushur objektivin e pjesëmarrjes së gruas në shërbimin civil deri në pesëdhjetë për qind deri në vitin 2050".

Vlerësimi i amendamentit të propozuar

30. Amendamenti i propozuar do të shqyrtohet nga Gjykata në pajtim me fushëveprimin e vlerësimit të përkufizuar më lart.
31. Gjykata vëren se amendamenti i propozuar në nenin 96 të Kushtetutës përmban dy elemente. Elementi i parë është që ta futë kuotën gjinore prej 40% (dyzet për qind), e cila, sipas deputetëve, është e barasvlershme me përfaqësimin proporcional të popullatës. Elementi i dytë ka të bëjë me kuotën prej 40% (dyzet për qind), të aplikueshme vetëm në postet ministrore dhe zëvendësministrore në Qeveri.
32. Gjykata më tej vëren se amendamenti i propozuar, siç arsyetohet nga deputetët, mund të konsiderohet të jetë formë e kualifikuar e diskriminimit pozitiv ose e veprimit afirmativ, me ç'rast grave u jepet përparësi në mënyrë automatike dhe pa kushte, pavarësisht kriterit të kualifikimeve profesionale.
33. Përveç kësaj, natyra e diskriminimit pozitiv ose e veprimit afirmativ, në përgjithësi, është e përkohshme, derisa të jetë arritur një qëllim i caktuar, sipas nenit 24.3 të Kushtetutës. Në anën tjetër, një normë kushtetuese perceptohet si diçka e natyrës së përhershme, me qëllim që të sigurojë një rend të qëndrueshëm kushtetues dhe juridik. Kjo është në harmoni me parimin e sigurisë juridike.
34. Gjykata, po ashtu, vëren se fushëveprimi i nenit të tanishëm 96 të Kushtetutës përfshin komunitetet joshumicë, siç janë ai "*serb, rom, ashkali, egjiptian, boshnjak, turk, goran dhe pjesëtarët e tyre*", që qartazi përfshijnë pjesëtarët meshkuj dhe femra.
35. Prandaj, amendamenti i propozuar duhet të shqyrtohet në kontekstin e të drejtave të këtyre komuniteteve, të garantuara me Kushtetutë.
36. Siç u përmend më lart, fushëveprimi i zbatimit të amendamentit të propozuar aplikohet vetëm për postet ministrore dhe për ato zëvendësministrore brenda Qeverisë.

37. Gjykata thekson se përderisa Kapitulli I [Dispozitat Themelore] i Kushtetutës definon strukturën e shtetit të Republikës së Kosovës dhe vlerat e saj, neni 3 [Barazia para Ligjit], paragrafi 2, i Kushtetutës përcakton: “*Ushtrimi i autoritetit publik në Republikën e Kosovës bazohet në parimet e barazisë para ligjit të të gjithë individëve dhe në respektimin e plotë të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të pranuar ndërkombëtarisht, si dhe në mbrojtjen e të drejtave dhe në pjesëmarrjen e të gjitha komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre*”. Prandaj, vetë organet shtetërore duhet të krijojnë mekanizma përkatës për realizimin e të drejtave të garantuara të qytetarëve.

38. Gjykata, gjithashtu, rikujton se neni 7 [Vlerat] i Kushtetutës, parasheh veçanërisht:

“1. Rendi kushtetues i Republikës së Kosovës bazohet në parimet e lirisë, paqes, demokracisë, barazisë, respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut dhe sundimit të ligjit, mosdiskriminimit, të drejtës së pronës, mbrojtjes e mjedisit, drejtësisë sociale, pluralizmit, ndarjes së pushtetit shtetëror dhe ekonomisë së tregut.

2. Republika e Kosovës siguron barazinë gjinore si vlerë themelore për zhvillimin demokratik të shoqërisë, mundësi të barabarta për pjesëmarrje të femrave dhe meshkujve në jetën politike, ekonomike, sociale, kulturore dhe në fushat të tjera të jetës shoqërore”.

39. Nga dispozitat e mësipërme rrjedh se barazia, mosdiskriminimi dhe barazia gjinore, *inter alia*, janë pjesë e rendit kushtetues dhe përbëjnë themelin demokratik të shoqërisë së Kosovës. Zbatimi i tyre praktik është me rëndësi jetike për zhvillimin e demokracisë.

40. Në mënyrë që të bëhet vlerësimi i plotë i amendamentit të propozuar, Gjykata gjithashtu merr parasysh instrumentet ndërkombëtare, të parapara në nenin 22 [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare] të Kushtetutës, lidhur me mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore.

41. Neni 22 i Kushtetutës parasheh:

“Të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare në vijim, garantohen me këtë Kushtetutë, zbatohen drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës dhe kanë prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike:

(1) *Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut;*

(2) *Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj;*

(3) *Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile e Politike dhe Protokollet e saj;*

[...]

(6) *Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas;*

[...]"

42. Marrëveshjet dhe instrumentet e lartpërmendura ndërkombëtare, që garantojnë të drejtat e njeriut dhe liritë themelore, përfshirë parimin e barazisë, janë pjesë e rendit juridik të Republikës së Kosovës.
43. Gjykata rithekson se parimi i barazisë është një nga parimet themelore të sistemit kushtetues të Republikës së Kosovës dhe garanton barazinë gjinore të të gjithë qytetarëve në rendin e saj kushtetues dhe ligjor.
44. Në Kushtetutë ka edhe referenca të tjera në barazinë gjinore, për shembull:
- a) në nenin 71 [Kualifikimet dhe Barazia Gjinore], paragrafi 2, të Kushtetutës: *“Përbërja e Kuvendit të Kosovës do të respektojë parimet e barazisë gjinore të cilat janë të pranuar në pajtim me parimet ndërkombëtare”;*
 - b) në nenin 101 [Shërbimi Civil], paragrafi 1, të Kushtetutës: *“Përbërja e shërbimit civil do të pasqyrojë shumëllojshmërinë e popullit të Kosovës, duke marrë në konsideratë parimet e barazisë gjinore, të njohura ndërkombëtarisht”;*
 - c) në nenin 104 [Emërimi dhe Shkarkimi i Gjyqtarëve], paragrafi 2, të Kushtetutës: *“Përbërja e gjyqësorit pasqyron shumëllojshmërinë etnike të Kosovës dhe parimet e pranuar ndërkombëtarisht të barazisë gjinore”;*
 - ç) në nenin 108 [Këshilli Gjyqësor i Kosovës], paragrafi 2, të Kushtetutës: *“[...] Këshilli Gjyqësor i Kosovës siguron që gjykatat në Kosovë të jenë të pavarura, profesionale e të paanshme, dhe të pasqyrojnë plotësisht natyrën shumetnike të Republikës së Kosovës e të ndjekin parimet e barazisë gjinore. Këshilli do t’u japë përparësi për emërim si gjyqtarë, anëtarëve të komuniteteve të nën përfaqësuar në mënyrën e përcaktuar me ligj”;*
 - d) në nenin 108 [Këshilli Gjyqësor i Kosovës], paragrafi 4, të Kushtetutës: *“Propozimet për emërimin e gjyqtarëve duhet të bëhen në bazë të procesit të hapur për emërim, në bazë të meritave të kandidatëve, dhe ky propozim pasqyron parimin e barazisë gjinore dhe përbërjen etnike të juridiksionit territorial të gjykatës përkatëse. Të gjithë kandidatët duhet t’i plotësojnë kriteret e përcaktuara me ligj”;*
 - dh) në nenin 109 [Prokurori i Shtetit], paragrafi 4, të Kushtetutës: *“Prokurori i Shtetit pasqyron përbërjen shumetnike të Republikës së Kosovës dhe respekton parimet e barazisë gjinore”;*
 - e) në nenin 110 [Këshilli Prokurorial i Kosovës], paragrafi 1, të Kushtetutës: *“[...] Këshilli Prokurorial i Kosovës siguron qasje të*

barabartë në drejtësi për të gjithë personat në Kosovë. Këshilli Prokurorial i Kosovës siguron që Prokurori i Shtetit të jetë i pavarur, profesional, i paanshëm dhe pasqyron natyrën shumetnike të Kosovës dhe parimet e barazisë gjinore”;

- ë) në nenin 110 [Këshilli Prokurorial i Kosovës], paragrafi 3, të Kushtetutës: *“Propozimet për emërimin e prokurorëve duhet të bëhen në bazë të procesit të hapur për emërimë, në bazë të meritave të kandidatëve, dhe ky propozim pasqyron parimin e barazisë gjinore dhe përbërjen etnike të juridiksionit territorial përkatës”;* dhe
- f) në nenin 114 [Përbërja dhe Mandati i Gjykatës Kushtetuese], paragrafi 1, të Kushtetutës: *“[...] Parimet e barazisë gjinore do të respektohen”.*
45. Garancitë e lartpërmendura kushtetuese të barazisë gjinore janë në linjë me shumë kushtetuta të vendeve demokratike dhe me instrumente e rekomandime ndërkombëtare.
46. Në këtë drejtim, Kushtetuta e Republikës së Bullgarisë, në nenin 6 (2) parasheh: *“[...] Nuk ka privilegje dhe kufizime mbi bazën e racës, kombësisë, vetidentitetit etnik, gjinisë, origjinës, religjionit, arsimimit, mendimit, përkatësisë politike, statusit personal ose shoqëror ose statusit të pronës”.*
47. Kushtetuta e Republikës së Qipros, në nenin 28 (2), parasheh: *“Secili person gëzon të gjitha të drejtat dhe liritë e parapara me këtë Kushtetutë pa asnjë diskriminim të drejtpërdrejtë apo të tërthortë ndaj ndonjë personi mbi bazën e komunitetit, racës, religjionit, gjuhës, gjinisë, bindjeve politike dhe të tjera, prejardhjes kombëtare apo sociale, lindjes, ngjyrës, pasurisë, klasës shoqërore, apo mbi çfarëdo baze tjetër, përveç shprehimisht nëse është përcaktuar ndryshe në këtë Kushtetutë”.*
48. Kushtetuta e Republikës së Çekisë përfshin konceptin e barazisë dhe parimin e mosdiskriminimit në nenin 3 të saj [Karta e të Drejtave dhe Lirive Themelore], ku thuhet: *“Secilit i garantohet gëzimi i të drejtave dhe lirive themelore pa dallim të gjinisë, racës, ngjyrës së lëkurës, besimit dhe religjionit, bindjeve politike dhe të tjera, prejardhjes kombëtare dhe sociale, të qenit pjesëtar i një pakice nacionale apo etnike, pronës, lindjes ose statusit tjetër”.*
49. Kushtetuta e Republikës së Letonisë, në nenin e saj 91, në një pjesë të saj parasheh: *“Të drejtat e njeriut realizohen pa diskriminim të çfarëdo lloji”.*
50. Kushtetuta e Republikës së Sllovakisë, në nenin e saj 12, paragrafi 2, thotë si në vijim: *“Të drejtat dhe liritë themelore i garantohen secilit në territorin e Republikës Sllovaqe pavarësisht gjinisë, racës, ngjyrës së lëkurës, gjuhës, besimit dhe religjionit, përkatësisë politike ose bindjeve tjera, prejardhjes nacionale ose sociale, kombësisë dhe prejardhjes etnike, pronës, prejardhjes, ose statusit tjetër. Askush nuk mund të dëmtohet, preferohet ose diskriminohet mbi këto baza”.*
51. Kushtetuta e Republikës së Sllovenisë, në nenin 14, përcakton që secilit i garantohen barabar të drejtat e njeriut dhe liritë themelore pa dallim të

prejardhjes nacionale, racës, gjinisë, gjuhës, religjionit, bindjeve politike dhe të tjera, gjendjes materiale, lindjes, arsimimit, statusit social, aftësisë së kufizuar ose çfarëdo rrethane tjetër personale.

52. Përveç kësaj, Gjykata i referohet Rekomandimit Rec. (2003)3 të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës për “Pjesëmarrjen e barabartë të femrave dhe meshkujve në sjelljen e vendimeve politike dhe publike” (Miratuar nga Komiteti i Ministrave, më 12 mars 2003, në mbledhjen e 831-të të zëvendësministrave). Në Kapitullin e tij për Masat Legjislative dhe Administrative, ndër të tjera, ai parasheh:

“Vendet anëtare duhet:

- a. Të marrin parasysh ndryshime kushtetuese dhe/ose legjislative, përfshirë masat e veprimit pozitiv, të cilat do të lehtësonin një pjesëmarrje më të baraspeshuar të meshkujve dhe femrave në vendimmarrjen politike dhe publike;*
- b. Të marrin parasysh miratimin e reformave legjislative për të vendosur pragje të barazisë për kandidatë në zgjedhjet e nivelit lokal, rajonal, nacional dhe supranacional. Aty ku ka lista proporcionale të merret parasysh vendosja e sistemit ziper (sistemi zik-zak);*
- c. Të marrin parasysh veprime ku nëpërmjet financimit publik të partive politike, ato inkurajohen për të promovuar barazinë gjinore;*
- ç. Atje ku është treguar se sistemet zgjedhore kanë ndikim negativ në përfaqësimin politik të femrave në organet e zgjedhura, duhet t'i përshtatin dhe reformojnë ato sisteme me qëllim që të promovohet përfaqësimi i baraspeshuar gjinor;*
- d. Të marrin parasysh miratimin e masave legjislative dhe/ose administrative për t'u siguruar që ekziston përfaqësim i baraspeshuar gjinor në tërë emërimet e bëra nga një ministër apo nga qeveria në komisionet publike;*
- dh. Të sigurojnë se do të ketë përfaqësim të baraspeshuar gjinor në pozita ose funksione bartësit e të cilave emërohen nga qeveria ose autoritete tjera publike;*
- e. Të sigurojnë që proceset e përzgjedhjes, rekrutimit dhe emërimit për pozitat udhëheqëse në vendimmarrjen publike kanë parasysh gjininë dhe janë transparente;*
- ë. Të marrin parasysh masa legjislative dhe/ose administrative me qëllim të inkurajimit dhe të përkrahjes së punëdhënësve ashtu që ata të lejojnë personat që marrin pjesë vendimmarrje politike dhe publike, të kenë të drejtë të marrin kohë të lira nga puna, pa u ndëshkuar;*
- f. Të inkurajojnë parlamentet në të gjitha nivelet që të themelojnë komisione parlamentare ose delegacione për të drejtat e grave dhe*

mundësi të barabarta dhe të zbatojnë trendet kryesore gjinore në tërë punën e tyre”.

53. Siç shihet nga referencat e lartpërmendura, Kushtetuta e Republikës së Kosovës në mënyrë të barabartë përmban garancitë e njohura ndërkombëtarisht për barazinë gjinore.
54. Bazuar në këtë, Gjykata konsideron se me futjen e kuotës së ndërlidhur me gjininë për postet ministrore dhe zëvendësministrore, amendamenti i propozuar ngushton zbatueshmërinë e garancive kushtetuese për barazinë gjinore. Prandaj, ai pakëson të drejtat për një pjesëmarrje më të baraspeshuar në organet publike.
55. Për më tepër, duhet të merret parasysh edhe neni 96, paragrafi 6, i Kushtetutës. Kjo dispozitë thekson në mënyrë të qartë se ministrat, në radhë të parë, mund të zgjidhen nga radhët e deputetëve të Kuvendit. Prandaj, deputetët e Kuvendit mund të aplikojnë parimin e barazisë gjinore dhe përfaqësimin proporcional përdorur për votime për pozicionet ministrore. Kuvendi vetë përbën një njësi me prani të ndryshme gjinore. Së dyti, neni 96 parasheh mundësinë që ministrat të zgjidhen nga njerëz të kualifikuar, të cilët nuk janë deputetë të Kuvendit, përkatësisht, të bëhen nominime të bazuara në merita.
56. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se përbërja e Qeverisë reflekton vullnetin politik të Kuvendit, pa marrë parasysh nëse ministrat e zëvendësministrat janë figura publike, ose persona të kualifikuar.
57. Një rregullim kushtetues i kuotës gjinore për pozicionet ministrore dhe zëvendësministrore mundet më tej, në praktikë, të shndërrohet në një zëvendësim formal të një personi të gjinisë së njëjtë që mund t'i zvogëlojë të drejtat e njerëzve të tjerë, qoftë deputetë ose persona të kualifikuar, për t'u bërë pjesë e Qeverisë.
58. Gjykata Evropiane e Drejtësisë (Shih Rastin C-409/95, *Kalanke c Freie Hanstadt Bremen* (1995), Vendimi i 17 tetorit 1995), shqyrtoi një dispozitë të Shtetit të Bremenit, sipas së cilës grave duhej dhënë përparësi ndaj kandidatëve meshkuj me kualifikime të barabarta me rastin e avancimit në një sektor ku gratë ishin të nënpërfaqësuar. Gjykata Evropiane e Drejtësisë vendosi që, dispozita që u jepte grave përparësi absolute ndaj meshkujve për punësim ose për avancim, nuk përfshihet në qëllimin për mundësi të barabarta të përfaqëuar nga Direktiva 76/207 EEC. Problemi ishte se ligji i Shtetit të Bremenit, për dallim nga ligjet e ngjashme gjermane, nuk linte të hapur mundësinë për përjashtime përballë karakteristikave specifike të kandidatit që mund të jenë relevante për pozitën.
59. Gjithashtu, Këshilli Kushtetues i Francës, në një vendim të vitit 1982, refuzoi si jokushtetues një propozim për të kufizuar përqindjen maksimale të cilësdo gjini në listat e kandidatëve për zgjedhje lokale në 75 për qind. Këshilli konsideroi se kuotat binin ndesh me parimet kushtetuese të barazisë dhe të universalitetit që ndalonin çdo ndarje në kategori të zgjedhësve dhe të personave që do të zgjedhen.

60. Në bazë të shembujve të lartpërmendur, Gjykata vëren, *inter alia*, se nuk është praktikë e zakonshme ekzistimi i dispozitave kushtetuese që rregullojnë pjesëmarrjen në organe publike nëpërmjet kuotave gjinore. Në të vërtetë, duhet të zbatohet parimi i mundësive të barabarta, edhe të grave e edhe të burrave. Praktika kushtetuese nuk përcakton një formë të kualifikuar të diskriminimit pozitiv, ku përparësia jepet automatikisht dhe pa kusht në baza gjinore, pavarësisht kriterëve të meritës profesionale.
61. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se deputetët nuk kanë dorëzuar ndonjë dëshmi mbështetëse që tregon se garancitë e tanishme kushtetuese të parimit të barazisë gjinore janë të pamjaftueshme për të garantuar barazinë gjinore dhe përbëjnë *“një situatë të rëndë të diskriminimit”*. Në të vërtetë, barra e të provuarit bie mbi deputetët, të cilët nuk kanë paraqitur ndonjë argument të arsyetuar dhe ndonjë provë relevante.
62. Deputetët konsiderojnë se eksperiencia negative e mosimplementimit të Ligjit për barazi gjinore, Nr. 2004/2, të 19 shkurtit 2004, i cili përfshin të gjitha institucionet dhe organet udhëheqëse, është një arsye tjetër që kjo normë të bëhet dispozitë kushtetuese dhe që Kushtetuta të jetë garantuese e barazisë gjinore.
63. Përkitazi më këtë, Gjykata dëshiron t’i referohet nenit 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit], paragrafi 4, të Kushtetutës, që përcakton:
- “Qeveria e Republikës së Kosovës është përgjegjëse për zbatimin e ligjeve e politikave shtetërore dhe i nënshtrohet kontrollit parlamentar”.*
64. Në bazë të asaj që u tha më lart, Gjykata vëren se përgjegjësia për implementimin e Ligjit për barazinë gjinore, Nr. 2004/2, bie mbi Qeverinë, e cila i nënshtrohet kontrollit nga Kuvendi, por ajo përsërit se është Kuvendi ai që voton dhe e zgjedh Qeverinë.
65. Për më tepër, Gjykata vlerëson se deputetët i referohen nenit 24, paragrafi 3, të Kushtetutës. Megjithatë, Gjykata konsideron se referenca në këtë dispozitë kushtetuese nuk është mbështetur, pasi deputetët nuk kanë arsyetuar se amendamenti i propozuar do të ishte i nevojshëm për të mbrojtur dhe për të avancuar barazinë gjinore në Qeveri.
66. Duke u bazuar në përfundimin se Kushtetuta siguron garanci të mjaftueshme që gjinitë të përfaqësohen dhe të marrin pjesë në mënyrë të barabartë në jetën publike, Gjykata më tej konsideron se gratë me kualifikime të barabarta me burrat, në shoqërinë kosovare duhet të përfshihen më gjerë në jetën publike, në formimin dhe funksionimin e organeve shtetërore. Kjo duhet të arrihet nëpërmjet zbatimit të parimeve, të vlerave dhe të mekanizmave kushtetues.
67. Për arsyet e lartcekura, Gjykata konkludon se amendamenti i propozuar pakëson të drejtat kushtetuese të garantuara në Kapitullin II dhe në Kapitullin III të Kushtetutës si dhe shkronjën dhe frymën e saj, siç përcaktohet me praktikën gjyqësore të Gjykatës. Prandaj, amendamenti i propozuar nuk është në pajtueshmëri me Kushtetutën.

PËR KËTO ARSYE


Gjykata, në mbështetje të nenit 113.9 dhe të nenit 144.3 të Kushtetutës, të nenit 20 të Ligjit dhe të rregullit 56 (a) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 10 mars 2015, njëzëri

VENDOS

- I. TË SHPALLË të pranueshme kërkesën nga Kryetari i Kuvendit, të dorëzuar më 6 shkurt 2015, me amendamentin e propozuar të Kushtetutës së Republikës së Kosovës;
- II. TË SHPALLË që amendamenti i propozuar pakëson të drejtat dhe liritë e njeriut të përcaktuara në Kapitullin II dhe në Kapitullin III të Kushtetutës, si dhe shkronjën e frymën e saj, siç përcaktohet në praktikën gjyqësore të Gjykatës;
- III. T'UA KUMTOJË këtë aktgjykim palëve dhe ta publikojë në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- IV. Ky aktgjykim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese

Snezhana Botusharova



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese

Prof. dr. Enver Hasani

